

# Takimi V Vjetor Ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca



## INTEGRIMI I DIASPORËS NË SHKENCËN, EKONOMINË DHE KULTURËN SHQIPTARË



**Tiranë, 2-5 shtator 2010**

Shqip: <http://www.iash-takimet.org>, Anglisht: <http://www.iash-meetings.org>

## Thirrje për pjesëmarrje drejtuar anëtarëve të IASH-së si dhe studiuesve të tjerë të interesuar

*Të nderuar Kolege e Kolegë,*

*Kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në **Takimin V Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca** (Tiranë, 2-5 shtator 2010).*

*Takimet e përvitshme të Institutit shërbejnë për të paraqitur arritjet më të reja shkencore të anëtarëve të IASH-së e të studiuesve të tjerë si dhe për të nxitur njohjen e bashkëpunimin e shkencëtarëve shqiptarë kudo që ndodhen.*

*Ato kanë si qëllim gjithashtu krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për forcimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve akademike – shqiptare e të huaja – e ndërmarrjen e projekteve kërkimore të përbashkëta.*

*Takimi V i Institutit Alb-Shkenca, përmes temës-bosht “**Integrimi i diasporës në shkencën, ekonominë dhe kulturën shqiptare**” do të synojë, ndër të tjera, ndriçimin e ndihmesës së jashtëzakonshme të kësaj pjese vitale të kombit në të kaluarën e në të tashmen si dhe përvijimin e rrugëve, strukturave, mekanizmave e programeve konkrete për fuqizimin e bashkëveprimit të saj me hapësirën shqiptare në Ballkan në kontekstin e sfidave të integrimit kombëtar e të atij euroatlantik dhe të epokës së globalizimit.*

*Në Takimin V Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca do të mbahen dhjetë konferenca shkencore me një varg simpoziumesh/sesionesh në kuadër të tyre.*


*Veprimtari të tjera do të jenë: Mbledhja e Përgjithshme e Institutit, mbledhjet e Bordit Drejtues e të Administratës Qendrore të tij si dhe veprimtari kulturore.*

*Komunikimi gjatë Takimit do të zhvillohet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze.*

*Faqet e internetit për takimin V të Institutit Alb-Shkenca, në të cilat do të lexoni informacionet aktuale për konferencat dhe ku do të mund të realizoni regjistrimin tuaj, janë:*

*Në shqip: <http://www.iash-takimet.org>*

*Në anglisht: <http://www.iash-meetings.org>*



## KËSHILLI ORGANIZUES

Ardian MAÇI, kryetar  
Fatos YLLI, nënkryetar  
Kristaq JORGO, nënkryetar  
Lindita KOMANI, nënkryetare  
Edlira F. MULLA, nënkryetare  
Gentiana TARE (Shqipëri)  
Evan RROÇO (Shqipëri)  
Lluka QAFOKU (Shqipëri)  
Mimoza KOKA (Shqipëri)  
Edlira SADIKU (Shqipëri)  
Nikolla P. QAFOKU (SHBA)  
Burim KAMISHI (Kosovë)  
Musa RIZAJ (Kosovë)  
Ali CAKA (Kosovë)  
Nebi CAKA (Kosovë)  
Bajram BERISHA (Kosovë)  
Fetah PODVORICA (Kosovë)  
Ramë VATA (Kosovë)  
Zeqirja NEZIRI (Maqedoni)  
Mustafa IBRAHIMI (Maqedoni)  
Bajram KAMBERI (Maqedoni)  
Mentor HAMITI (Maqedoni)

## KËSHILLI SHKENCOR

Adriano FRANCESCANGELI (Itali)  
Ali CAKA (Kosovë)  
Altin STAFI (Itali)  
Anila HODA (Shqipëri)  
Arben MERKOÇI (Spanjë)  
Ardian HARRI (SHBA)  
*Kryetar i Seksionit të Ekonomisë*  
Ardian MAÇI (Shqipëri)  
Avdullah HOTI (Kosovë)  
Bajram BERISHA (Kosovë)  
Bajram KAMBERI (Maqedoni)  
Besnik DOBI (Shqipëri)  
Burim KAMISHI (Kosovë)  
Caterina ZUCCARO (Itali)  
Edlira F. MULLA (Shqipëri)  
Emil LAJE (Shqipëri)  
Esat STAVILECI (Kosovë)  
Eshref JANUZAJ (Gjermani)  
Evan RROÇO (Shqipëri)  
Fatos OLLDASHI (Shqipëri)

Fatos YLLI (Shqipëri)  
Fetah PODVORICA (Kosovë)  
Gentian ZYBERI (Holandë)  
*Kryetar i Seksionit të Drejtësisë*  
Gianluigi DE GENNARO (Itali)  
Hysni OSMANI (Kosovë)  
Ismail DUMAN (Turqi)  
Italo C. FORTINO (Itali)  
Jahja KOKAJ (Kuvajt)  
Kristaq JORGO (Shqipëri)  
Lindita KOMANI (Austri)  
Lulzim DRAGIDELLA (Gjermani)  
*Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Politike*

LLuka P. QAFOKU (Shqipëri)  
Margarita IFTI (Shqipëri)  
Mazllum BELEGU (Kosovë)  
Mimoza KOKA (Shqipëri)  
Mirela BOGDANI (Angli)  
Musa RIZAJ (Kosovë)  
*Kryetar i Seksionit të Inxhinierisë dhe Teknologjisë së Informacionit*  
Musaj PAÇARRIZI (Kosovë)  
Naim SHABANI (Gjermani)

*Kryetar i Seksionit të Mjekësisë*  
Naser RAMADANI (Kosovë)  
Nebi CAKA (Kosovë)  
Nikolla P. QAFOKU (SHBA)  
*Kryetar i Seksionit të Bujqësisë dhe Mjedisit*  
Pandi ZDRULI (Itali)  
Petrit ZORBA (Shqipëri)  
Ramadan JASHARI (Belgjikë)  
Ramë VATA (Kosovë)  
Robert MAGARI (SHBA)  
*Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore*

Roza ALLABASHI (Austri)  
Salih AHMETI (Kosovë)  
Sami REPISHTI (SHBA)  
Shefkije ISLAMAJ (Kosovë)  
Shpresa CASLLI (Shqipëri)  
Vincenzo TUCCILLO (Itali)  
Zeqirja NEZIRI (Maqedoni)  
*Kryetar i Seksionit të Shkencave Albanologjike e të Kulturës*

Dërgimi i titullit dhe përmbledhjes së punimit:	deri më <b>15 maj 2010</b>
Shpallja e përmbledhjeve të miratuara:	deri më <b>15 qershor 2010</b>
Regjistrimi për çdo pjesëmarrës	deri më <b>15 korrik 2010</b>
	Për anëtarët e IASH-së <b>30 euro</b> , për të tjerët <b>60 euro</b>
Regjistrimi për çdo pjesëmarrës	deri më <b>2 shtator 2010</b>
	Për anëtarët e IASH-së <b>30 euro</b> , për të tjerët <b>100 euro</b>
Dërgimi i punimit për botim:	deri më <b>30 shtator 2010</b>

Pagesa aktualisht bëhet **vetëm** pranë degës së Institutit Alb-Shkenca në Tiranë në llogarinë:

Banka Intesa SanPaolo

Instituti Alb-Shkenca

Nr. i llogarisë: 1047731801 (Euro)

Swift Code: USALALTR

IBAN: AL68208110080000001047731801

([http://www.intesasanpaolobank.al/web/Deget\\_e\\_Tiranes.php](http://www.intesasanpaolobank.al/web/Deget_e_Tiranes.php))

Si alternativë, pagesën mund ta kryeni edhe në llogarinë e Institutit Alb-Shkenca në PayPal (sistemin e kemi të instaluar prej kohësh në portalin e Institutit <http://www.alb-shkenca.org>).

Pagesat e kryera në Kosovë dhe Maqedoni tek persona të paautorizuar nuk do të merren parasysh.

Për pyetjet që mund të keni, na shkruani në adresën e Takimit ([tv2010@alb-shkenca.org](mailto:tv2010@alb-shkenca.org)) ose në atë të degës së IASH-së në Tiranë ([iash.tirana@alb-shkenca.org](mailto:iash.tirana@alb-shkenca.org))

Konferencat shkencore në kuadër të Takimit V të IASH-së:

- I. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Albanologjike dhe të Kulturës**
- II. Konferenca e Seksionit të **Shkencave të Drejtësisë**
- III. Konferenca e Seksionit të **Shkencave të Bujqësisë**
- IV. Konferenca e Seksionit të **Shkencave të Mjedisit**
- V. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Ekonomike**
- VI. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Natyrore**
- VII. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Mjekësore**
- VIII. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit**
- IX. Konferenca e Seksionit të **Shkencave Shoqërore dhe Politike**
- X. Konferenca **“Integrimi i diasporës në hapësirën shqiptare në Ballkan”**

- Pjesëmarrësit ftohen të paraqesin arritjet më të reja të veprimtarisë së tyre kërkimore-shkencore
- Kumtesat / ligjëratat duhet të jenë **origjinale, të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi** ose botimi
- Nga secili autor do të pranohen **jo më shumë se dy kumtesa** për një konferencë dhe **tri për të gjithë Takimin**
- Kusht i domosdoshëm për botimin e punimit në revistën shkencore “**Aktet e Takimeve Ndërkombëtare Vjetore të Institutit Alb-Shkenca**” është pjesëmarrja në konferencë e autorit të parë të punimit
- Deri më **15 maj 2010**, në adresën e seksionit përkatës, duhet të dërgohet titulli i kumtesës me përmbledhjen, e cila të ketë **të paktën 150 fjalë** dhe **jo më shumë se 250 fjalë**, sipas modelit që jepet në faqen 10
- Nuk do të pranohen, për asnjë arsye, kërkesa për shtyrjen e afatit të dorëzimit të përmbledhjes, sepse kjo do të vonojë procesin e botimit të tyre në një vëllim të veçantë, i cili do të shpërndahet në fillim të Takimit bashkë me AKTET e dy Takimeve të mëparshme
- Përmbledhjes së kumtesës duhet t’i paraprijë shënimi se në cilin simpozium ajo kërkohet të paraqitet
- Varianti për botim i kontributeve duhet të jetë **në gjuhën shqipe ose angleze**, i formatuar sipas rregullave të IASH-së, të cilat do të dërgohen më vonë
- Është mirë që të interesuarit të kontaktojnë me përgjegjësit për organizimin e konferencave
- Në fund të Takimit do të organizohet ceremonia e dhënies së çmimit: “**Kumtesa më e mirë**” për çdo konferencë shkencore. Fituesit do të nderohen me një pllakatë dhe me çmimin përkatës
- Në qoftë se dëshironi të ndihmoni në organizimin e konferencave /simpoziumeve dhe nëse kërkonit informacion shtesë rreth Takimit V të IASH-së na shkruani në adresën:  
[tv2010@alb-shkenca.org](mailto:tv2010@alb-shkenca.org)





### III. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE TË BUJQËSISË

**Përgjegjës:** Ardian MAÇI (Shqipëri), Evan RROÇO (Shqipëri), Pandi ZDRULI (Itali), Nikolla P. QAFOKU (SHBA)


**Bashkëpunëtorë:** Shukri FETAHU (Kosovë)

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [bujqesia10@alb-shkenca.org](mailto:bujqesia10@alb-shkenca.org)

**Temat e simpoziumeve:** Do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve. Do të pranohen kumtesa që trajtojnë çështje nga të gjitha disiplinat/fushat e Seksionit (bujqësi, veterinari, zooteknikë, shkencat pyjore).

Tema të përgjithshme:

1. Zhvillime në studimet mbi prodhimin bimor
2. Zhvillime në studimet mbi prodhimin shtazor
3. Zhvillime në shkencat pyjore
4. Zhvillime në veterinari



### IV. KONFERENCA E SHKENCAVE TË MJEDISIT

**Përgjegjës:** Edlira F. MULLA (Shqipëri), Nikolla P. QAFOKU (SHBA), Roza ALLABASHI (Austri), Pandi ZDRULI (Itali)

**Bashkëpunëtorë:** Florije TAHIRI (Kosovë), Adriano FRANCESCANGELI (Itali), Gianluigi de GENNARO (Itali),

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [mjedisi10@alb-shkenca.org](mailto:mjedisi10@alb-shkenca.org)


**Temat e simpoziumeve:**

1. Cilësia e ajrit dhe ndotësit e tij
2. Cilësia e ujit dhe ndotësit e tij
3. Cilësia e dherave dhe ndotësit e tyre (Tokat/bujqësia dhe mjedisi)
4. Trajtimi i mbetjeve urbane
5. Menaxhimi i mjedisit
6. Etika dhe edukimi mjedisor
7. Inxhinieria dhe mjedisi




**V. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE EKONOMIKE****Përgjegjës:** Ardian HARRI (SHBA), Mimoza KOKA (Shqipëri), Avdullah HOTI (Kosovë).**Bashkëpunëtorë:** Ardiana GASHI (Kosovë), Abdilmenaf BEXHETI (Maqedoni), Lindita KOMANI (Austri).Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [ekonomia10@alb-shkenca.org](mailto:ekonomia10@alb-shkenca.org)**Temat e simpoziumeve:**


1. Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë
2. Zhvillimi i qëndrueshëm i financës dhe i bankave
3. Zhvillimi i qëndrueshëm i biznesit

**VI. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE NATYRORE****Përgjegjës:** Robert MAGARI (SHBA), Margarita IFTI (Shqipëri), Fatos YLLI (Shqipëri)**Bashkëpunëtorë:** Burim KAMISHI (Kosovë), Lluka QAFOKU (Shqipëri), Jahja KOKAJ (Kuvajt), Sevdije GOVORI (Maqedoni), Petrit ZORBA (Shqipëri), Musaj PAÇARIZI (Kosovë), Anila HODA (Shqipëri).Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [natyra10@alb-shkenca.org](mailto:natyra10@alb-shkenca.org)**Temat e simpoziumeve:**

1. Arritje shkencore në fizikë, matematikë dhe astronomi
2. Arritje shkencore në kimi, biokimi dhe biologji
3. Arritje shkencore në fushën e sistemeve komplekse

**VII. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE****Përgjegjës:** Naim SHABANI (Gjermani)**Bashkëpunëtorë:** Fatos OLLDASHI (Shqipëri) Ramadan JASHARI (Belgjikë), Naser RAMADANI (Kosovë), Mazllum BELEGU (Kosovë), Salih AHMETI (Kosovë), Bajram KAMBERI (Maqedoni), Altin STAFI (Itali)Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [mjekesia10@alb-shkenca.org](mailto:mjekesia10@alb-shkenca.org)**Temat e simpoziumeve:** Do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve. Do të pranohen kumtesa që trajtojnë çështje nga të gjitha disiplinat/fushat kërkimore të Seksionit:

1. Mjekësi e përgjithshme
2. Stomatologji
3. Farmaci
4. Simpozium për nder të Profesor Musa Haxhiut





## VIII. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE INXHINIERIKE DHE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

**Përgjegjës:** Musa RIZAJ (Kosovë), Shpresa CASLLI (Shqipëri), Murtezan ISMAILI (Maqedoni).  
**Bashkëpunëtorë:** Besnik DOBI (Shqipëri), Eshref JANUZAJ (Gjermani), Mentor HAMITI (Maqedoni),  
 Nebi CAKA (Kosovë), Hysni OSMANI (Kosovë), Ruzhdi SEFA (Kosovë)  
 Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [teknologjia10@alb-shkenca.org](mailto:teknologjia10@alb-shkenca.org)

**Temat e simpoziumeve:** Do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve. Do të pranohen kumtesa që trajtojnë çështje nga të gjitha disiplinat/fushat e Seksionit:

- |                         |                         |
|-------------------------|-------------------------|
| 1. Gjeologji            | 7. Inxhinieri elektrike |
| 2. Miniera              | 8. Kompjuteristikë      |
| 3. Materiale            | 9. Inxhinieri mekanike  |
| 4. Metalurgji           | 10. Gjeodezi            |
| 5. Inxhinieri kimike    | 11. Arkitekturë         |
| 6. Inxhinieri ushqimore | 12. Ndërtimtari         |

## IX. KONFERENCA E SEKSIONIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE DHE POLITIKE

**Përgjegjës:** Lulzim DRAGIDELLA (Gjermani), Aleksandër KOÇANI (Shqipëri), Naser ZABELI (Kosovë), Blerina KËLLEZI (Angli)

**Bashkëpunëtorë:** Ingrid STRATI (Itali), Mirela BOGDANI (Angli), Albert NIKOLLA (Shqipëri)  
 Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [shoqeria10@alb-shkenca.org](mailto:shoqeria10@alb-shkenca.org)

**Temat e simpoziumeve:**

1. Sociologjia dhe demografia: Popullsia dhe regjistrimi i saj
2. Psikologjia dhe pedagogjia  
(një nga nëntemat): Zhvillimi psikologjik i fëmijëve dhe vështirësitë në nxënie
3. Shkencat edukologjike: Edukimi, arsimit dhe inkluzioni
4. Puna Sociale: Puna sociale, rëndësia dhe detyrat e saj në tejkalimin e problemeve sociale
5. Shkencat politike: Proceset e integritimeve europiane

**X. KONFERENCA “INTEGRIMI I DIASPORËS NË HAPËSIRËN SHQIPTARE NË BALLKAN”****Përgjegjëse:** Lindita KOMANI (Austri)Kontakti dhe dërgimi i punimeve: [projekte10@alb-shkenca.org](mailto:projekte10@alb-shkenca.org)

Konferenca është parashikuar si një veprimtari konkrete për të gjeneruar projekt-ide/ projekt-propozime për integrimin e diasporës shqiptare në fushat e ekonomisë, të kulturës e të shkencës në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni.

Pjesëmarrja do të mundësohet me dërgim projekt-idesh/projekt-propozimesh, të cilat do të përzgjidhen e do të paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tri seancat e Konferencës (Ekonomi, Kulturë, Shkencë). Seancat do të organizohen në formën e tryezave të rrumbullakëta me të ftuar të veçantë: përfaqësues të qeverisë së Shqipërisë, të Kosovës e të Maqedonisë dhe grupe pune të tyre; përfaqësues të institucioneve akademike e grupe pune të tyre, përfaqësues të firmave të biznesit e grupe pune të tyre.

Në ndryshim nga konferencat e tjera, përveç abstrakteve, deri në datën 30 qershor duhet dërguar një propozim i plotë në formë të shkruar si dokument në Word ose Pdf, shoqëruar me prezantim në Power Point. Formatu për projekt-propozimin do të vihet në dispozicion nga organizatorët e konferencës.

## MODELI I PËRMBLEDHJES/ABSTRAKTIT

Formati i faqes: A4. Margjinat: lart e poshtë: 2,5 cm; djathtas e majtas: 3 cm

Titulli i punimit në shqip

(dhe) Titulli i punimit në anglisht

(16pt Times New Roman, bold, në qendër)

EMRAT E AUTORËVE (Me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)

Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12pt Times New Roman, në qendër)

Adresa (12pt Times New Roman, në qendër); SHTETI (me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)

E-mail (për komunikim) (12pt Times New Roman, në qendër)

Përmbledhje: Teksti (11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet), 150-250 fjalë.

(ose) Abstract (anglisht): Teksti (11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet), 150-250 fjalë.

Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet)

Key-words (anglisht): 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet).

**Shënim:** Autori duhet të përcaktojë me kohë se në cilin simpozium dëshiron ta paraqesë punimin